

EPPC Albania & Kosovo, kërkon Supervizore Pastrimi për klientin e saj, që operon në Industrinë e Hoteleri-Turizmit në Ulqin (Mal i Zi).

## Qëllimi kryesor i punës:

- Përgjegjëse për të gjitha operacionet ditore që lidhen me mirëmbajtjen dhe ruajtjen e dhomave të hotelit, ambienteve publike, pishinë, duke u kujdesur të jenë kryer konform standarteve të cilësisë dhe politikave e procedurave të sigurisë;
- Verifikon dhe përditëson çdo ditë statusin e dhomave dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Planifikon, ndan dhe kontrollon në mënyrë të përpiktë detyrat e stafit të pastrimit duke u siguruar të kryhen në kohë dhe në shërbim të kënaqësisë dhe komoditetit të klientëve;
- Bashkëpunon ngushtë me të gjitha departamentet e tjera si recepsioni, lavanderia, departamenti teknik, me qëllim koordinimin me sukses dhe në kohë të aktiviteteve të përditshme;
- Asiston në përzgjedhjen e stafit të pastrimit dhe i trajnon ata në lidhje me detyrat që duhet të kryejnë;
- Mirëpret dhe suporton me informacion në mënyrë të sjellshme, etike dhe profesionale klientët.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- E preferueshme të jetë nga Veriu i Shqipërisë (Shkodër, Lezhë, Laç etj.) ose nga Kosova;
- Të zotërojë shumë mirë gjuhën Shqipe dhe Malazeze (*domosdoshmëri*);
- Diplomë gjimnazi, ose diplomë profesionale në Hoteleri-Turizëm;
- E gatshme të zhvendoset për punë në Ulqin/Mal i Zi, (*veçanërisht gjatë sezonit turistik*);
- Përvoja e mëparshme në pozicione të tilla ose të ngjashme, përbën avantazh;
- Njohuri të mira kompjuterike.

## Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Supervizore Pastrimi;
<b>Vendndodhja:</b>	Ulqin (Mal i Zi);
<b>Orari:</b>	48 orë në javë;
<b>Kontrata:</b>	Sezonale (Prill – Tetor), me mundësi rinovimi ;
<b>Pagesa:</b>	450 EURO net/muaj;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	15.12.2016.

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj me fotografi në Anglisht dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur pozicionin për të cilin aplikoni në adresën e e-mail-it:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.